



- Të Reja ▾
- Policia e Shtetit ▾
- Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar
- Shërbime ▾
- Baza ligjore
- Vendndodhjet e policisë
- Video
- Programi i transparencës ▾
- Kontakt
- Denonco Krimin Kibernetik
- Drejtoritë Vendore të Policisë ▾
- Policia Kufitare ▾
- Policia Rrugore ▾
- Donacione
- Rubrika Policimi në Komunitet ▾
- Përmbledhja Javore
- Për sinjalizimin

Breaking News: DVP Vlorë – Vihen në pranga 2 shtetas, procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër

Shkodër/Informacione paraprake

Policia e Shtetit – Vijon megaoperacioni policor i koduar "Highway"

Sarandë/Zbardhet dhe dokumentohet ngjarja e ndodhur më datë 20.09.2023, për të cilën një 33-vjeçar deklaroi se ishte dëmtuar aksidentalisht, nga plasja e një fisheku luftarak Korçë/Plagosi me mjet të mprehtë 2 shtetas, kapet dhe shoqërohet në Polici, autori i dyshuar i ngjarjes.



Lajmet

19/10/2023

Sarandë/Zbardhet Dhe Dokumentohet Ngjarja E Ndodhur Më Datë 20.09.2023, Për Të Cilën Një 33-Vjeçar Deklaroi Se Ishte Dëmtuar Aksidentalisht, Nga Plasja E Një Fisheku Luftarak

Sarandë/Zbardhet dhe dokumentohet ngjarja e ndodhur më datë 20.09.2023, për të cilën një 33-vjeçar deklaroi se ishte dëmtuar aksidentalisht, nga plasja e një fisheku luftarak.

Vihen në pranga 33-vjeçari, pasi nga hetimet rezultoi se ishte vetëplagosur aksidentalisht, me një armë zjarri të cilën e posedonte pa leje.

Në pranga dhe 2 shtetas të tjerë të cilët dyshohet se fshehën armën e zjarrit dhe bënë kallëzime të rreme, për të penguar zbulimin e së vërtetës.

Si rezultat i hetimeve të thelluara, të kryera menjëherë pas ngjarjes së ndodhur më datë 20.09.2023, në fshatin Stjar, Delvinë, ku shtetasi H. M. deklaroi se ishte dëmtuar aksidentalisht, gjatë kohës që punonte në tokën e tij, nga plasja e një fisheku luftarak, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Sarandë, në bashkëpunim me Prokurorinë e rrethit, bënë të mundur zbardhjen dhe dokumentimin e ngjarjes, për të cilën u vunë në pranga shtetasit:

-H. M., 33 vjeç, banues në fshatin Stjar, Delvinë, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit";

-M. M., 63 vjeç dhe L. R., 51 vjeç, të dy banues në fshatin Stjar, Delvinë, për veprat penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" dhe "Kallëzimi i rremë".

Nga provat e siguruar dyshohet se më datë 20.09.2023, shtetasi H. M. është vetëplagosur aksidentalisht, gjatë kohës që punonte në tokën e tij, me një armë zjarri të cilën e posedonte pa leje. Gjithashtu, dyshohet se shtetasi M. M. dhe L. R. kanë fshehur armën e zjarrit, si dhe se kanë bërë kallëzime të rreme, me qëllim pengimin e zbulimit të së vërtetës së kësaj ngjarjeje.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për veprime të mëtejshme.

◀ Korçë/Plagosi me mjet të mprehtë 2 shtetas, kapet dhe shoqërohet në Polici, autori i dyshuar i ngjarjes.

Policia e Shtetit – Vijon megaoperacioni policor i koduar "Highway" ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON



Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)